



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Të tjera materiale dhe shërbime speciale”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Kodi CPV – 44810000-1 (Bojra)**
- **Kodi CPV – 24200000-6(Ngjyra pigmente)**
- **Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme 44100000-1**

1. VLERE E FONDIT LIMIT : 1 663 000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) Lekë pa T.V.SH , për llogari të Ndërmarrjes Komunale dhe fondi është vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja Komunale, Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

Sipas kushteve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit

2.1.1. Ofertuesi duhet të paraqesi Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, r, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo me te vogël se 15% të vlerës së fondit limit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.3 Ofertuesi duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në orën 10 në datën e hapjes së ofertave mostra të mallrave si më poshtë :

- **BOJË AKRILIKE.**
- **BOJË ZMALTO**
- **BOJË HIDROPLASTIKE**

Mos paraqitja në orarin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përbën shkak për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin mostra të mallrave të kërkuar nga AK.

Lidhur më kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit arsyeton se është e rëndësishme për autoritetin kontraktor kërkesa për mostrat për mallrat e sipërcituar. Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i kontratës me sukses dhe në kohë, duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Bazuar mbi legjislacionin në fuqi, njësia e prokurimit gjykon se është më efikase për autoritetin kontraktor garancia se ofertuesit disponojnë mallrat objekt prokurimi përpara dhënies së kontratës duke paraqitur mostrat përkatëse në përputhje me specifikimet teknike në datën e përcaktuar nga ky i fundit .

Duke u nisur edhe nga përvojat e mëparshme për procedurat e nisura nga autoriteti kontraktor të cilat kanë rezultuar efikase në të gjitha rastet kur janë kërkuar mostrat të mallrave objekt prokurimi në përputhje me përcaktimet e nenit 40, pika 6 gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, janë zbatuar kontratat me rigorozitet, cilësi dhe në kohë.

2.2.4 Ofertuesit duhet të vetëdeklarojë se për mallrat objekt prokurimi do të lëshojnë garanci 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të mallrave.

Operatori ekonomik ofertues do të paraqesë një deklaratë që merr përsipër furnizimin me mallra pranë autoritetit kontraktor.

Ky kriter plotësohet me vetëdeklarim

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi

ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit sipas kontratave të ngjashme në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar .